



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:009276

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05125195

Ep.nr.26/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KRM “AMBIENTI”, SH.A, me adresë rruga ”Xh S”, F e P rruga e T, p.n, në Pejë, ndaj debitorit K.B-RA Q- K.M, me adresë në rrugën “N. T”, p.n, Pejë, me bazë juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1470/19, i datës 23.10.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit K. B-RA Q- K. M, me adresë në rrugën “N. T”, p.n, Pejë, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri i Përmbaruesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1470/19, i datës 23.10.2019, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 775.16 euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor i Përmbaruesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1470/19, i datës 23.10.2019, sa i përket shumës prej 189.00 euro.

A r s y e t i m

Kreditori K “A”, SH.A., me seli në Pejë, me datë 23.10.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktet e verifikuara nga librat

afariste për pagesat e shërbimeve të bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.10.2004 e deri më 30.09.2019, në shumën prej 964.16 euro.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr./I.Br.1470/19, i datës 23.10.2019, duke lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datën 25.11.2021, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor, nën arsyetimin se: e mohon borxhin që i vihet në barrë për arsye se faturimi është regjistruar në mënyrë të gabuar ngase borxhi është parashkruar nga 01.01.2004 e deri me 23.11.2020, meqenëse ka kaluar më shumë se një vit nga faturimi i borxhit sipas nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së. Po ashtu kreditori nuk ka dëshmuar faturat në bazë të cilave është lejuar përmbartimi dhe të cilat janë dorëzuar te debitori. Sa i përket borxhit nga data 23.11.2020 e deri me 23.11.2021 e tutje, debitori shpreh gatishmërinë ta paguaj, duke i propozuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbartimor ndërsa prapësimin ta aprovoj si të bazuar.

Kreditori lidhur me pretendimet në prapësim nuk ka dhënë përgjigje në prapësim.

Gjykata në procedurën përmbartimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrin përmbartimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbartim të kreditorit të datës 23.10.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1470/19, i datës 23.10.2019, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën kohore nga data 01.10.2004 e deri më 30.09.2019, në shumën prej 964.16 euro, në emër të bartjes së mbeturinave.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbartimore, është dokumenti juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbartim, dhe si i tillë plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP-së), që përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2.*

ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.*

Gjykata pas konstatimit të ligjshmërisë të urdhrit përmbarimor, gjen se prapësimi i debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit për arkëtimin e borxhit në rrugë gjyqësore, është pjesërisht i bazuar, konform nenit 374 par.1 të LMD-së së ish-RSFJ-së dhe nenit 355 par.1 të LMD-së.

Gjykata parashkrimin e borxhit për periudhën nga 01.10.2004 e deri më 18.12.2012, e ka zbatuar dispozitat e LMD-së të ish-RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënia juridike civile, kurse nga 19.12.2012 e tutje, gjykata ka zbatuar dispozitat e LMD-së të vitit 2012.

Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, që përfshin periudhën kohore nga 01.10.2004 e deri më 23.10.2016 në shumë prej 775.16 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmbarim, e ka paraqitur më datën 23.10.2019 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 01.10.2004 e deri më 23.10.2016 është parashkruar, sepse ka kaluar afati 3 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkoj përmbushjen gjyqësore të detyrimit referuar 374 par.1 dhe 2 të LMD-së të ish-RSFJ-së, që përcakton *“Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer” dhe nenit 355 par.1 dhe 2 të LMD-së, që përcakton se: “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjithë borxhi i akumuluar 01.10.2004 e deri më 23.10.2016 në lartësi prej 775.16 euro është parashkruar, sepse kreditori për këtë periudhë kohore paraqitjen e

propozimit për përbarim e ka bërë me datë 23.10.2019, pas kalimit të afatit 3 vjeçar të paraparë me nenin 355 par.1 të LMD-së.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata konstaton se debitori detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 189.00 euro për shërbimin e bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga 01.11.2016 e deri më 30.09.2019, për shkak se borxhi i tillë për këtë periudhë nuk është parashkruar.

Kreditori me paraqitjen e propozimit për përbarim të datës 23.10.2019, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.11.2016 e deri më 30.09.2019. Kjo për shkak se parashkrimi i borxhit nga data 01.11.2016 do të parashkruhej pas tri vitesh, respektivisht me 01.11.2019, borxhi i vitit 2017 do të parashkruhej pas tri vitesh, respektivisht në vitin 2020, borxhi i vitit 2018, do të parashkruhej në vitin 2021, kurse borxhi i vitit 2019, do të parashkruhej në vitin 2022. Nga të lartë cekurat, rezulton se kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përbarim e ka paraqitur me 23.10.2019, e cila kërkesë është brenda afatit tre vjeçar të paraparë me nenin 355 par.1 të LMD-së.

Paraqitja e propozimit ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga 01.11.2016 e deri më 30.09.2019 në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.”*

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 189.00 euro t’ia paguaj kreditorit.

Gjykata thekson se për zhvillimin e procedurës përbarimore sipas ekstraktit afarist, nuk është e nevojshme të ketë krahas ekstraktit edhe faturat për të dëshmuar detyrimet e debitorit, përderisa ekstrakti afarist është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përbarim. Për më tepër gjykata thekson se procedura përbarimore zbatohet përmes aplikueshmerisë së parimit të rigoroz dhe formal, përmes së cilës bëhet vetëm vlerësimi i ligjshmërinë formale të urdhrit përbarimor dhe dokumentit të besueshëm dhe në këtë drejtim, gjykata nuk mund të lëshohet në shqyrtimin material të përmbajtjes së tij dhe fakteve eventuale kontestuese.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi

pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe nenit 355 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:009276
Ep.nr.26/2022, me datë 27.12.2023.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes Gjykatës Themelore në Pejë.